



**KOMITETI SHETËROR PËR
KULTET**

RAPORT VJETOR

I PUNËS

VITI 2018

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

PËRMBAJTJA:

1- HYRJE	4
<ul style="list-style-type: none">• KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI ROLIN E KSHK DHE ORGANIZIMIN I TIJ.• VËSHTRIM I SHKURTËR RRETH SITUATËS SË LIRISË SË FESË E BESIMIT NË SHQIPËRI.• KUADRI INSTITUCIONAL FETAR NË SHQIPËRI.	
2- OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA DHE DREJTIMET PËR REALIZIMIN E TYRE GJATË VITIT 2018	7
<ul style="list-style-type: none">❖ MARRËDHËNIET ME BASHKËSITË FETARE.❖ MARRËDHËNIET ME SHOQATAT/FONDACIONET/ORG. ME KARAKTER FETAR.❖ MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET QENDRORE DHE VENDORE.❖ MARRËDHËNIET ME HOMOLOGË/ORGANIZATA/PËRFAQËSUES NDËRKOMBËTARË PËR ÇËSHTJE TË LIDHURA ME FENË.❖ PROJEKTI: “IDENTIFIKIMI I OBJEKTEVE TË KULTIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”.	
3- AKTIVITETE TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2018.....	13
4- BUXHETI PËR VITIN 2018.....	16
<ul style="list-style-type: none">• ZËRAT EKONOMIKË DHE REALIZIMET E TYRE.• PROKURIMET PËR BLERJET E VOGLA.	
5- REKOMANDIME.....	19

SHKURTESAT

ATP – AGJENSIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

BF – BASHKËSI FETARE

IMK – INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

KSHK – KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

KMSH – KOMUNITETI MYSLIMAN I SHQIPËRISË

KOASH – KISHA ORTODOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË

KKSH – KISHA KATOLIKE NË SHQIPËRI

KBB – KRYEGJYSHATA BOTËRORE BEKTASHIANE

VUSH – VËLLAZËRIA UNGJILLORE E SHQIPËRISË

MEPJ – MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

MSHMS – MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MASR – MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

1 – HYRJE

Komiteti Shtetëror për Kultet, si një institucion qendror, në varësi të Kryeministrit, vepron në bazë të VKM-së Nr. 459, datë 23.09.1999 dhe në ushtrimin e detyrës së tij i nënshtrohet zbatimit të të drejtës kushtetuese të lirisë së fesë e besimit dhe të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, në këtë fushë. Mbarëvajtja e institucionit është bërë e mundur në sajë të bashkëpunimit shumëpalësh me Bashkësitë, OJF me karakter fetar dhe me institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor. Gjatë vitit 2018, veprimtaria e KSHK është udhëhequr nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani Strategjik 2018 – 2021, ku janë të përcaktuara qartë objektivat dhe mënyrat e realizimit të tyre. Institucioni është treguar i kujdesshëm që të forcojë klimën e respektit për besimin fetar në vend, si një faktor për fuqizimin e bashkëjetesës fetare tradicionale dhe si vlerësim për kontributin shoqëror - arsimor - shëndetësor të bashkësive dhe organizatave fetare në jetën shqiptare.

❖ KONSIDERATA TË PËRGJITHSHME MBI ROLIN E KSHK DHE ORGANIZIMIN I TIJ.

Komiteti Shtetëror për Kultet ka si funksion kryesor “*Realizimin e marrëdhënieve ndërmjet shtetit dhe komuniteteve fetare e organizatave shoqërore të çdo lloji, që kanë objekt veprimtarie dhe ndjekin qëllime fetare*”.

Ky institucion synon dhe ka si përparësi të veprimtarisë së vet punën për:

- Zbatimin e detyrimeve kushtetuese;
- Plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e shtetit me fenë;
- Zbutjen dhe shuarjen e konflikteve që mund të çënojnë harmoninë ndërfaqetare në vend.

Përgjegjësitë kryesore të KSHK mund të përmbliken si vijon:

- Bashkërendimin e marrëdhënieve me komunitetet fetare, shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare.
- Garantimin e lirisë së besimit e për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfaqetare në Shqipëri duke qenë asnjnjës në çështjet e besimit dhe duke njohur barazinë e bashkësive fetare dhe respektuar pavarësinë e tyre.
- Shprehjen e mendimit të tij Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, lidhur me planin mësimor, programet dhe tekstet e pjesës jolaike, për kërkesat e paraqitura për hapjen e institucioneve arsimore jopublike, institucioneve arsimore plotësuese jopublike, ku zhvillohen lëndë fetare dhe në

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

bashkëpunim me atë institucion, në varësi të ndarjes administrative territoriale, të interesave të përbashkëta ekonomike dhe të traditës historike e fetare.


- Interesimin për ruajtjen e vlerave të objekteve të kultit në bashkëpunim me Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe me komunitetet fetare
- Paraqitjen e konsideratave të tija Ministrisë së Financave, lidhur me hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të mallrave me karakter fetar për komunitetet fetare dhe për përjashtimin e tyre nga taksa doganore, në përputhje me ligjet në fuqi.
- Vendosjen dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet homologe të vendeve të tjera e të diasporës, në funksion të promovimit të bashkëjetesës fetare në vend.

ORGANIZIMI I KSHK

Në bazë të VKM –së, Nr. 602 i datës 10/09/2014, Komiteti Shtetëror për Kultet funksionon si një trup i vetëm, në përbërjen e të cilit përfshihen:

1 Kryetar, 5 Anëtarë, 3 Specialistë dhe një punonjës mbështetës.

ORGANIGRAMA



Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

❖ **VËSHTRIM I SHKURTËR RRETH SITUATËS SË LIRISË SË FESË E BESIMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2018.**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë , me nenet 10 dhe 24:

Neni 10

1. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka fe zyrtare. 2. Shteti është asnjans në çështjet e besimit e të ndërgjegjes dhe garanton lirinë e shprehjes së tyre në jetën publike. 3. Shteti njih barazinë e bashkësive fetare. 4. Shteti dhe bashkësitë fetare respektojnë në mënyrë të ndërsjelltë pavarësinë e njëritjetrit dhe bashkëpunojnë në të mirë të secilit dhe të të gjithëve. 5. Marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare rregullohen mbi bazën e marrëveshjeve të lidhura ndërmjet përfaqësuesve të tyre dhe Këshillit të Ministrave. Këto marrëveshje ratifikohen në Kuvend. 6. Bashkësitë fetare janë persona juridikë. Ato kanë pavarësi në administrimin e pasurive të tyre sipas parimeve, rregullave dhe kanoneve të tyre, për sa nuk cenohen interesat e të tretëve.

Neni 24

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar. 2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve. 3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

garanton këtë të drejtë dhe ligjet mbështetëse në këtë fushë, rrisin efektivitetin dhe bëhen provë e fuqishme e zbatimit në jetë të këtyre të drejtave. Këtë e dëshmon panorama e larmishme fetare e vendit tonë, ku ndërthuren fe dhe tradita fetare të ndryshme, dhe ku, krahas 5 komuniteteve kryesore fetare, të cilat kanë ratifikuar marrëveshje reciproke me Qeverinë Shqiptare, ushtrojnë misionin e tyre, edhe të “besimeve të vogla”, të përfaqësuara nga dhjetëra fondacione, organizata apo shoqata.

E drejta e lirisë apo besimit fetar, rrjedh gjithashtu, nga angazhimet në nivel ndërkombëtar, që shteti shqiptar ka pranuar dhe zbatuar. Shqipëria ka ratifikuar 9 traktate ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtës së fesë apo besimit dhe pjesëmarrjen dhe rolin aktiv të saj në Këshillin Evropian.

Rezultatet e arritura në këtë drejtim, janë bërë objekt i vlerësimit të lartë nga ana e organizmave ndërkombëtare të interesuar në këtë fushë. Këtë e dëshmojnë deklaratat nga takimet dhe raportet e ndryshme të përfaqësuesve ndërkombëtarë, ku evidencohet roli pozitiv dhe inkurajues i shtetit shqiptar për ushtrimin dhe mbrojtjen e lirisë së fesë apo besimit, dëshmi e të cilës është mungesa, pothuajse totale, e rasteve të diskriminimit për shkak të përkatësisë fetare apo e problemeve sistematike dhe thelbësore në këtë fushë.

❖ KUADRI INSTITUCIONAL FETAR NË SHQIPËRI.

Bashkësitë fetare si vijon: 1) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, 2) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, 3) Kisha Katolike në Shqipëri, 4) Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe 5) Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, të njohura si të tilla në sajë të marrëveshjeve të ndërsjella me Këshillin e Ministrave, të ratifikuara në parlament me ligjet përkatëse (Ligji nr. 8902, datë 23/05/2002, Ligji nr. 10056, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10057, datë 22/01/2009, Ligji nr. 10058, datë 22/01/2009, ligji nr. 10394, datë 10/03/2011), ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre të besimit, edukimit fetar, aktiviteteve, shërbesave etj. Katër prej këtyre bashkësive asistohen financiarisht nga shteti shqiptar për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve laikë të administratës dhe arsimit, në zbatim të ligjit Nr. 10140, datë 15.05.2009. Për vitin 2018, shuma e akorduar nga qeveria shqiptare ishte 109.000.000 lekë, e shpërndarë sipas VKM Nr. 245, datë 09.05.2018.

Krahas bashkësive fetare të sipërpërmendura, në Republikën e Shqipërisë ushtrojnë të drejtën kushtetuese të lirisë së fesë, edhe të cilësuarat “besime të vogla apo të reja” si: Baha’i, Dëshmitarët e Jehovait, Kisha e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Xhemati Ahmaddya, etj. që veprojnë nëpërmjet shoqatave/ organizatave/ fondacioneve me karakter humanitaro – fetar, të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, në zbatim të ligjit Nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse” .

2 - OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA DHE DREJTIMIT PËR REALIZIMIN E TYRE GJATË VITIT 2018.

Komiteti Shtetëror për Kultet, duke iu referuar në çdo aspekt të aktivitetit të tij, legjislacionit të fushës dhe, duke i qëndruar besnik rolit të tij të “mediatorit” në marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë, punon bazuar në një plan afatmesëm (PBA) për vitet 2018 – 2021 ku përcaktohen qartë objektivat, shoqëruar me mënyrat dhe aktivitetet e realizimit të tyre.

Sipas këtij programi, objektivi kryesor, i cili është i lidhur ngushtësisht me vetë qëllimin e krijimit të institucionit, është:

Ruajtja dhe forcimi i harmonisë e bashkëjetesës fetare të trashëguar, duke përmirësuar kushtet e veprimtarisë së tyre arsimore e shpirtërore me anë të mbështetjes financiare dhe hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim.

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

Sigurisht, ky program aktualizohet nëpërmjet përcaktimit të qartë të objektivave specifike, për të cilët ndiqen veprimtaritë kryesore, të gjitha të pasqyruara në PBA.

Rreth këtij boshti përqëndrohet gjithë aktiviteti institucional, i cili mund të ndahet në disa drejtime:

❖ **MARRËDHËNIET ME BASHKËSITË FETARE: KMSH, KOASH, KKSH, KKB, VUSH.**

Qeveria shqiptare çmon misionin e bashkësive fetare si përhapës të virtyteve dhe vlerave të shëndosha morale, por në të njëjtën kohë vlerëson kontributin e tyre shoqëror në parandalimin, sensibilizimin dhe zgjidhjen e plagëve sociale. Parë në këtë këndvështrim, objektivi i KSHK, në marrëdhëniet me BF mund të përmblihet si mëposhtë:

Thellimi dhe forcimi i bashkëpunimit me Bashkësitë Fetare dhe zgjidhja e problematikave shqetësuese që kanë të bëjnë me ushtrimin e misionit të tyre në vend, për të krijuar kushtet optimale të shprehjes së të drejtës kushtetuese së lirisë së fesë e besimit.

Për realizimin e këtij objektivi, KSHK është mobilizuar në harkun e gjithë vitit, për të siguruar të drejtën kushtetuese të lirisë së besimit dhe fesë, në zbatim të direktivave qeveritare në këtë fushë.

Drejtimet kryesore në këtë drejtim kanë qenë:

a) Adresimi dhe zgjidhja e problematikave me karakter ligjoro – administrativ, në të cilën mund të përfshihen aktet apo propozimet ligjore/nënligjore për forcimin e rolit të BF në sferën shoqërore shqiptare dhe krijimi i lehtësirave fiskale për ushtrimin optimal të misionit të tyre. Vlen të përmenden VKM Nr. Nr. 245, datë 09.05.2018 për financimin nga buxheti shtetëror të BF dhe ulja e tarifave të ujit për to (nga 140 lekë/m³ në 65 lekë/m), në zbatim të vendimit të ERRU, Nr.31, datë 27/04/2018, “Mbi disa ndryshime në vendimin e mëparshëm për përcaktimin e kategorisë së konsumatorëve, për disa klientë të veçantë”.

b) Adresimi dhe zgjidhja e problematikave me karakter fetar, e cila kërkon një trajtim të veçantë, delikat dhe të pjekur, për të ruajtur ekuilibrat mes BF, në respekt të pozicionit asnjans të shtetit dhe në zbatim të detyrës për forcimin e bashkëjetesës paqësore fetare shqiptare.

c) Bashkëpunimi në shërbim të të mirës së përbashkët, për zgjidhjen e plagëve sociale dhe për promovimin e bashkëjetesës tradicionale fetare në Shqipëri e jashtë saj, e cila përmbledh thelbin e misionit të feve të ndryshme, por edhe një nga objektivat kryesorë të KSHK. Neni 10 që sanksionon ndarjen e shtetit nga feja, nuk përjashton bashkëpunimin e ngushtë për të mirën e shoqërisë, prandaj edhe qëllimi i KSHK, si institucion shtetëror, është ngritja e urave të bashkëpunimit me BF dhe mes

tyre. Iniciativat në kërtë drejtim, gjatë vitit 2018 kanë përfshirë aktivitete të përbashkëta, të cilat përmenden në kapitullin e posaçëm të këtij raporti ¹

❖ **MARRËDHËNIET ME SHOQATAT/FONDACIONET/ORGANIZATAT ME KARAKTER HUMANITARO – FETAR.**

Në detyrat institucionale të Komitetit përfshihet: “... *Bashkërendimi i marrëdhënieve me shoqatat, fondacionet fetare ose humanitare-fetare*”.

Kësaj detyre ligjore, i është kushtuar një vëmendje e veçantë, duke patur parasysh numrin e madh të këtyre organizmave dhe efektin që ushtrojnë në jetën shoqërore në vend. Gjatë vitit 2018 mbështetja dhe pjesëmarrja e KSHK në iniciativat e OJF për t’iu ardhur në ndihmë shtresave në nevojë, ka qenë e vazhdueshme dhe këto pasqyrohen në tabelën e aktiviteteve. Nga ana tjetër, KSHK është e ndërgjegjshme për influencën e huaj në financimet e disa OJF, gjë që bën akoma më të nevojshëm rishikimin e legjislacionit lidhur me OJF, që nga kriteret e regjistrimit e deri në vazhdimësinë e aktivitetit të tyre për transparencë.

Duke patur parasysh zbatimin e Udhëzimit Nr. 16, datë 16.09.2009, të Ministrit të Financave, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim – taksave” dhe Udhëzimit Nr. 22, datë 19.11.2014, “Për mbikqyrjen e OJF –ve, nga organet tatimore, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, akoma mbeten të paqarta shumë të dhëna lidhur me aktivitetin e OJF që nuk janë regjistruar, atyre me status “pasiv” apo atyre që nuk dorëzojnë deklaratat tatimore sipas legjislacionit në fuqi. Pengesë për kontaktimin e tyre bëhet mungesa e adresave të qarta, si pasojë e papërgjeshmërisë dhe mosprofesionalizmit në momentin e regjistrimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.

❖ **MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET QENDRORE DHE VENDORE.**

Në zbatim të VKM –së nr. 459, datë 23.09.1999, për përmbushjen e misionit institucional, si hallkë lidhëse mes shtetit dhe fesë në Republikën e Shqipërisë, KSHK – ja bashkëpunon fuqimisht me institucione të ndryshme shtetërore, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë lokal. Gjatë vitit 2018 këto marrëdhënie janë konkretizuar në rezultate që janë pasqyruar në aktivitete të përbashkëta, në zgjidhje problematikash të bashkësive fetare apo organizatave humanitaro – fetare, në shkëmbime mendimesh e takime të vazhdueshme për projekte të ardhshme. Duke patur parasysh politikën qeveritare për të cilat feja është jo vetëm një transmetues vlerash morale e virtytesh, por edhe një partner i fuqishëm në jetën socio – ekonomike të vendit, institucioni ka intensifikuar përpjekjet e tij për zgjidhjen e drejtë të shqetësimeve, duke u angazhuar plotësisht, herë – herë duke luftuar edhe me burokracinë e aparatit. Në nivel qendror bashkëpunimi ka qenë i frytshëm me:

¹ Paraqitur në tabelën e aktiviteteve.

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

- **Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.** Kontributi i KSHK ka qenë i konsiderueshëm për të përgatitur raporte të ndryshme që janë paraqitur pranë organizmave ndërkombëtarë (OSBE, Takim Ministerial në USA, etj.) që trajtojnë të drejtat e njeriut, sidomos atë të besimit fetar. Këto raporte kanë shërbyer si pasqyrë e rolit garantues nga ana e shtetit shqiptar, të ushtrimit të plotë të kësaj të drejte dhe si mjete promovuese të bashkekzistencës paqësore fetare në vendin tonë.

- **Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.** Në kuadër të projektit pilot për mësimin mbi fenë në shkollat publike, takimet dhe shkëmbimet e mendimeve me përfaqësues të këtij institucioni dhe konsulentë të huaj të ngarkuar nga kjo ministri, kanë qenë të vlefshme. Roli i KSHK –së është të përcjellë gjithashtu mendimet, vëzhgimet dhe /apo vlerësimet e bashkësive fetare lidhur me këtë proces.

- **Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.** Lidhur me përpilimin dhe zbatimin e akteve normative bazuar në ligjin Nr. 10140, datë 15.05.2009, “Për financimin nga buxheti i shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave” dhe me nevojat institucionale të hartimit të PBA, MFK etj. Kontaktet me MFE kanë qenë të vazhdueshme dhe të frytshme.

- **Pushtetin Vendor.** Duke pasur parasysh misionin dhe shtrirjen e besimit në të gjithë territorin, një rëndësi të posaçme, gjatë vitit 2018 i është kushtuar komuniteteve lokale. Qëllimi i tyre ka qenë vlerësimi i nivelit të marrëdhënieve mes pushtetit vendor dhe përfaqësuesve fetarë lokalë, për të rritur klimën e bashkëpunimit në të mirë të zonës. Nga takimet e shumta ka rezultuar që shpesh këto marrëdhënie mbeten në një nivel kortezie, pa u thelluar më tej. Ka patur edhe raste kur indiferenca, apo influenza e një komuniteti fetar lokal mbi pushtetin vendor ka ndikuar negativisht në aktivitetin e komuniteteve të tjera, duke u konsideruar prej këtyre të fundit, si mohim i të drejtës së besimit. KSHK, si hallkë e shtetit që është garantues i kësaj të drejte dhe asnjans e i barabartë ndaj bashkësive fetare, ka vendosur të thellojë shkëmbimet shumëpalëshe në nivel lokal për vitin e ardhshëm. Faktori fetar konsiderohet i një vlere të veçantë kontributive dhe sigurie, sidomos në zonat rurale.

❖ **MARRËDHËNIET ME HOMOLOGË/ORGANIZATA/PËRFAQËSUES NDËRKOMBËTARË PËR ÇËSHTJE TË LIDHURA ME FENË.**

Shqipëria po hedh hapat e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian, dhe një nga aspektet ku ajo shpall një kuadër të shëndoshë dhe solid legjislativ, lidhet me liritë e ndërgjegjes, fesë apo besimit fetar. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet neneve 10,18 dhe 24, njeh dhe garanton këto të drejta, qoftë individualisht apo dhe institucionalisht.

E drejta e lirisë apo besimit fetar, rrjedh gjithashtu nga angazhimet në nivel ndërkombëtar, që shteti shqiptar ka pranuar dhe zbatuar. Shqipëria ka ratifikuar 9 traktate ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, në respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtës së fesë apo besimit dhe pjesëmarrjen dhe rolin aktiv të saj në Këshillin Evropian.

Një nga organizmat kyç për trajtimin e lirisë dhe të drejtave të njeriut, është OSBE, aderimi në të cilën është realizuar gjatë punimeve të Këshillit Ministror të Berlinit në qershor 1991. Vendi ynë nënshkroi Aktin Final të Helsinkit më 16 shtator 1991 dhe Kartën e Parisit për një Evropë të Re më 17 shtator 1991. Ky aderim shënoi një ndryshim rrënjësor të kursit të politikës së jashtme shqiptare, që do ta çonte në dalje nga vetë-izolimi ndërkombëtar, në afrimin me bashkësinë euro-atlantike dhe në pranimin e vlerave perëndimore të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Aderimi i Shqipërisë u shoqërua me ndërmarrjen e reformave ligjore për respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të individit. OSBE ka Misione në të gjitha vendet Ballkanit Perëndimor, të cilat ve

projnë në përputhje me mandatet përkatëse të miratuara nga Këshilli i Përhershëm, organi kryesor vendimmarrës i OSBE-së, ku marrin pjesë ambasadorët e 57 vendeve pjesëmarrëse në Organizatë. Shqipëria punon që veprimtaritë e këtyre Misioneve të jenë efektive dhe t'i shërbejnë paqes, stabilitetit dhe integritetit evropian të rajonit. Vendi ynë bashkëpunon ngushtë edhe me institucionet e OSBE-së, si ODIHR dhe Zyra e Përfaqësuesit për Lirinë e Shtypit.

KSHK-ja, në përmbushje të detyrimeve ndërkombëtare të marra nga shteti shqiptar, ka qenë aktiv në trajtimin e temës së lirisë së fesë dhe besimit, nëpërmjet raportimeve vullnetare të paraqitura në sesionet e OSBE, në Vjenë, në 5 qershor 2018 dhe në “Ministerial to Advance Religious Freedom”, mbajtur në Ëashington në 24-26 korrik 2017. Në to u paraqit realisht roli i shtetit në respektimin e këtyre të drejtave themelore dhe masat e marra për ruajtjen e traditës shekullore të bashkëjetesës dhe dialogut fetar.

Një nga detyrat ligjore të KSHK –së, sipas VKM –së nr. 459, datë 23.09.1999, është: “*Vendos dhe zhvillon lidhje me institucionet homologe, të vendeve të tjera e të diasporës*”.

Duke e konsideruar këtë detyrë si zbatim të konventave ndërkombëtare, pjesë e të cilave është edhe shteti shqiptar dhe një shërbim për forcimin e të drejtës së besimit dhe fesë në vend, KSHK –ja, është aktivizuar intensivisht gjatë vitit 2018. Tema e modelit shqiptar të bashkekzistencës fetare është trajtuar gjerësisht në shumë në takime, bisedime, aktivitetete, programe, konferenca, etj. në nivel ndërkombëtar. Rëndësia e fesë në ditët e sotme, parë nën dritën e flukseve migratore, bën të nevojshme shpërndarjen e shembujve pozitivë. Ambasadat e ndryshme të akredituara në Tiranë, Departamenti Amerikan i Shtetit, Parlamenti Gjerman (Bundestag), Komisioni për Marrëdhëniet me Komunitetet Fetare dhe Grupet e Republikës së Maqedonisë etj., kanë kërkuar dhe vlerësuar kontributin institucional të KSHK për promovimin e traditës unike të bashkëjetesës fetare, si një hap drejt integritetit të Shqipërisë në BE.

❖ **PROJEKTI: “IDENTIFIKIMI I OBJEKTEVE TË KULTIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”.**


Ky projekt, i cili e ka zanafillën në fund të vitit 2016, është ideuar për të mbledhur të dhënat e objekteve të kultit të shpërndara në të gjithë territorin e vendit dhe për t'i paraqitur ato në një hartë digjitale. Qëllimi i këtij projekti është për t'i shërbyer shtetit në procesin e menaxhimit të territorit, në ruajtjen e vlerave kulturore – historike nëpërmjet ruajtjes së “ Monumenteve të Kulturës”, fuqizimit të turizmit me

karakter fetar në vend. Gjatë vitit 2018 janë plotësuar disa qarqe/zona të pambaruara nga vitit i kaluar, të cilat morfologjikisht kanë paraqitur vështirësi. Ndryshe nga viti 2017, ku është punuar me ritme të larta, gjatë 2018, për shkak të ndryshimit të procedurave të miratimit të udhëtimeve si zbatim i VKM-së Nr. 602, datë 10.09.2014 “Mbi disa ndryshime në Vendimin Nr. 459, datë 23.09.1999 për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet” dhe VKM –së Nr. 997, datë 10.12.2012, “ Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, ritmet e procesit të evidencimit kanë qenë në një nivel më të ulët. Ndërkohë, vëmendja është përqendruar në saktësimin e të dhënave, ballafaqimin e tyre me një pjesë të të dhënave që disponojnë vetë bashkësitë fetare, në konsultimin me specialistë të hartave digjitale etj.

TABELA E TË DHËNAVE TË MBLEDHURA DERI NË FUND TË VITIT 2018

OBJEKTE KULTI TË EVIDENCUARA				
KMSH + TARIKATE	KOASH	KKSH	KBB	VUSH
642 + 81	1078	62	400	10
TOTAL 2273				

PARAQITJA GRAFIKE E EVIDENCIMIT TERRITORIAL PËR VITIN 2018



3- AKTIVITETE TË ZHVILLUARA GJATË VITIT 2018.

Në VKM –në Nr. 459, datë 23.09.1999, një nga detyrat e Komitetit Shtetëror për Kultet cilësohet:”...

Ndihmon dhe mbështet veprimtarinë e mirëfillta fetare bazuar në Kushtetutën dhe në ligjet përkatëse, që rregullojnë problemet konkrete” dhe “...punon për garantimin e lirisë së besimit dhe për zhvillimin, bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe tolerancën ndërfaqetare në Shqipëri”.

Përveç përmbushjes së rolit institucional, pjesëmarrja aktive ka qenë një faktor moral duke patur parasysh se në to trajtohen tema të rëndësishme mbi efektin e feve në jetën arsimore, shëndetësore, në zgjidhjen dhe parandalimin e plagëve të ndryshme shoqërore shqiptare apo në kontributin historik dhe aktual të tyre në vend.

Qëllimi i pjesëmarrjes dhe kontributit institucional mund të përmbledhet në:

- Garantimin e të drejtës kushtetuese të lirisë së besimit dhe fesë, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që çojnë në zbatimin rigoroz të kësaj të drejte, në respekt të konventave evropiane dhe ndërkombëtare të ratifikuara nga qeveria shqiptare, për këtë temë.
- Promovimin e bashkëjetesës tradicionale fetare në Shqipëri si: seminare, trajnime, konferenca, forume, brenda dhe jashtë vendit, ku përcillet fryma e bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore dhe fetare, në të mirë të shoqërisë shqiptare.
- Mbështetje konkrete në iniciativat e komuniteteve lokale për parandalimin dhe shërimin e plagëve sociale.

Aktivitetet më domethënëse paraqiten në tabelën e mëposhtme:

AKTIVITETI	DATA	TEMA	PROBLEMATIKA
Leximi i Mesazhit të Papa Françeskut	Janar	“Emigrantë dhe refugjatë; burra e gra në kërkim të paqes”	Mikpritja dhe respektimi i kulturës, fesë e traditave të emigrantëve
Takimi i delegatëve të Konferenca ve Ileshknor e të Evropës	Shkurt	“Besimi dhe ana shpirtërore në marrëdhëniet mes të krishterëve dhe myslimanëve”	Dialogu ndërfetar bazuar në vlerat dhe virtytet fetare e morale
Dhënie çmimi nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme	Shkurt	“Vlerat e familjes”	Vlerësimi i kontributit social të personave/organizatave
Konferencë e OSBE, Amb. Holandeze	Shkurt	Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm	Rëndësia e bashkëpunimit shumëpalësh të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë në këtë proces

Asambleja e Përgjithshme e VUSH	Shkurt	Analiza e punës njëvjeçare të kësaj bashkësie fetare	Roli i shtetit dhe KSHK, në veçanti, në ruajtjen e marrëdhënieve me fetë dhe mes tyre.
Konferencë e KBB	Mars	“Vepra e Imam Aliut midis traditës dhe modernës”	Roli i figurave të fesë bektashiane në brumosjen e vlerave morale.
Konferencë ndërkombëtare në shkencat islame	Prill	“Sfidat e myslimanëve në shoqërinë e shekullit XXI”	Ndryshimet politiko – ekonomiko – shoqërore, flukset migratore dhe përballjet e fesë islame me to.
Takim ndërfetar i komuniteteve fetare - Shkodër	Prill	“Droga, fajdet dhe lojrat e fatit, sfida që nxisin besimet”	Parandalimi dhe shërimi i këtyre plagëve sociale, detyrë edhe e fesë, si pjesë e shoqërisë
Konferencë ndërkombëtare e Amb. Austriake - Tiranë	Maj	“Shqipëria, model i bashkëjetesës për Evropën?”	Shembulli unik i bashkëjetesës fetare shqiptare, si kontribut për integrimin në BE

Takim me diasporën dhe besimtarët bektashianë	Maj	Dita e kulturës Bektashiane	Roli paqedashës bektashian në realitetin e kaluar dhe të sotëm shqiptar
Takim konsultativ i ODHIR – OSBE - Shkup	Qershor	“Udhëzues për të kuptuar krimet e urrejtjes ndaj myslimanëve dhe adresimi i nevojave të këtyre të fundit”	Ndryshimet politiko – ekonomiko – shoqërore, flukset migratore dhe përballjet e fesë islame me to.
Angazhime në iftarë të ndryshëm	Qershor	Muaji i Shenjtë i Ramazanit për besimtarët myslimanë	Respektimi i traditave dhe normave fetare dhe mesazhet që përcjellin
Pjesëmarrje në pelegrinazhin e Malit të Tomorrit	Gusht	Respektim i figurës së Abaz Aliut	Respektimi i traditave dhe normave fetare dhe mesazhet që përcjellin në BE
Udientë me Papa Françeskun	Nëntor	Mbyllja e Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut	Bashkekzistenca vëllazërore fetare në Shqipëri, si shembull për t’iu dhënë botës

25 Vjetori i Caritas Albania	Dhjetor	P ëvjetori i kontributit	Roli i rëndësish ëm i strukturave fetare në mb ëshetje të atyre shtetërore, për t'iu ardhur në ndihmë shtresave në nevojë
Angazhime për Krishtlindje	Dhjetor	Vizita në Komunitetet e krishtera	Ndarje e momenteve festive me BF

4- BUXHETI PËR VITIN 2018

Komiteti Shtetëror për Kultet (KSHK) bazon veprimtarinë e tij në detyrat ligjore që rrjedhin nga VKM –ja Nr. 459, datë 23.09.1999 dhe harton politikat institucionale në zbatim të tyre. KSHK –ja i përmbahet legjislacionit në fuqi për fenë dhe për marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë, si edhe politikave qeveritare në këtë fushë.

Për këtë qëllim dhe në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit Nr. 7, datë 28.02.2018, Udhëzimit plotësues Nr. 7/2, datë 09/ 07/ 2018 dhe sugjerimeve prej fazës së parë të diskutimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të gjithë komponentët e PBA 2019-2021 harmonizojnë, politikat/ objektivat e Komitetit Shtetëror për Kultet, me shpërndarjen buxhetore për realizimin e tyre. Në zbatim të politikës së programit “Mbështetje për Kultet” si një mjet për garantimin e një mjedisi ku, çdo bashkësi fetare, të shprehë dhe praktikojë lirisht të drejtën kushtetuese të besimit dhe duke iu përmbajtur tavaneve buxhetore të miratuara me VKM –në Nr. 128, datë 07.03.2018, është bërë shpërndarja e fondeve buxhetore sipas artikujve ekonomikë, për secilin produkt. Përdorimi fondeve buxhetore e dtyron institucionin të zbatojë me përpikmëri ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke monitoruar vazhdimisht gjatë harkut vjetor, përputhshmërinë e shpenzimeve institucionale me shkallën e realizimit të objektivave. Treguesit e performancës janë përdorur si mjeti matës i pozicionimit të KSHK –

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

së. Në plotësimin e objektivave të pasqyruara në PBA –në e sipërpërmendur, duke përdorur me efikasitet dhe eficiency burimet financiare dhe njerëzore, KSHK –ja përgjithësisht dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik, veçanërisht, kanë ndjekur, hap pas hapi, ecurinë e realizimit të objektivave dhe përdorimin e fondeve përkatëse të destinuara për to, duke dhënë rekomandimet e rastit, duke korrigjuar dhe rialokuar fondet dhe duke ndërhyrë, në rast mangësish, për të realizuar arritjen e objektivave.


❖ ZËRAT EKONOMIKË DHE REALIZIMET E TYRE

Mëposhtë, në formë tabelash e grafikësh, jepet një pasqyrë e përmblodhur e planifikimit dhe realizimit buxhetor për vitin në fjalë, shoqëruar nga pasqyra e procedurave të prokurimit për blerje të vogla, të nevojshme për funksionimin optimal institucional.


SHPENZIME PERSONELI (Lekë)	PLANI VJETOR (Lekë)	REALIZIMI VJETOR (Lekë)	PËRQINDJA (%)
Zëri ekonomik 600 (PAGAT)	9,800,000	9,700,122,000	99%
Zëri ekonomik 601 (SIGURIMET SHËND. dhe SHOQ.)	1,600,000	1,571,999.000	98%
Zëri ekonomik 602 (MALLRA dhe SHËRBIME)	8,000,000	2,725,536.270	34%
Zëri ekonomik 604 (TRANSFERTA me të TRETË)	109,000,000	109,000,000.000	100%

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel +355042227131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

GRAFIKU I REALIZIMIT BUXHETOR PËR VITIN 2018



GRAFIKU I REALIZIMIT BUXHETOR NË % PËR VITIN 2018



Nga të dhënat e grafiqeve të mësipërm vihet re realizim i plotë i zërave ekonomikë 600,601 dhe 604 dhe një realizim i ulët i zërit ekonomik 602. Shkaqet e këtij mosrealizimi justifikohen me:

1) Mungesën e shpenzimeve buxhetore të planifikuara për prokurimin e parashikuar që lidhej me përpilimin e Hartës Dixhitale, e cila do të kurorëzonte Projektin e identifikimit të objekteve të kultit në terroerin e Shqipërisë. Nëpërmjet bashkëpunimit me ASIG, këto shpenzime do t'i kursehen buxhetit shtetëror.

2) Mungesën e shpenzimeve buxhetore për udhëtimet e parashikuara jashtë vendit, të cilat në shumicën e rasteve janë përballuar nga palët ftuese.

3) Mungesën e miratimit nga ana e SP të udhëtimeve brenda vendit, në zbatim të VKM – së Nr. 602, datë 10.09.2014, “ Mbi disa ndryshime në Vendimin Nr. 459, datë 23.09.1999 për krijimin e Komitetit Shtetëror për Kultet” dhe VKM –së Nr. 997, datë 10.12.2012, pika V/2, germa a.

❖ **PROKURIMET PER BLERJET E VOGLA.**

Për nevojat institucionale që të krijohen kushtet për realizimin e objektivave të KSHK –së, gjatë vitit 2018, janë realizuar një sërë prokurimesh për blerje me vlerë të vogël, të cilat i nënshtrohen dhe bëhen në zbatim të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “ Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe udhëzimeve që e shoqërojnë dhe që pasqyrohen si mëposhtë:

REGJISTRI I REALIZIMIT TE PROCEDURAVE TE PROKURIMIT 12- mujori i Vitit 2018

Autoriteti Kontraktor: KOMITETI SHKETËTOR PËR KULTET

Nr. rendor	Objekti i prokurimit	Tipi i Kontrates (mall/pune/sherbim/ Marreveshje Kuader	Lloji i procedurës së prokurimit/Minikontratë në kuadër të marrëveshjes kuadër /Amendament kontrate për nrvojat e fillim vitit	Fondi Limit me të cilin është shpallur procedura (pa TVSH)	Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit	Emri i operatorit ekonomik/bashkimi i operatoreve ekonomik i shpallur fitues dhe NUIS	Vlera e kontratës së nënshkruar	Organi që ka zhvilluar procedurën e prokurimit
1	Abonime ne shtypin vendas per vitin 2018	Shërbim	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	83,333	05.01.2018	Agjensia e Abonimit të Shtypit K31517010H	81,600	Komiteti Shtetëror për Kultet
2	Shërbime pastrimi	Shërbim	Amendim Kontrate	27,090	05.01.2018	S.L.M SH.P.K K71605001B	27,090	Komiteti Shtetëror për Kultet
3	Blerje kancelarie	Mall	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	100,000	27.02.2018	Onis Sh.p.k K01312004V	99,872	Komiteti Shtetëror për Kultet
4	Larje automjeti	Shërbim	Blerje me vlerë të vogël	58,640	08.03.2018	D&J, L41825004O	58,600	Komiteti Shtetëror për Kultet
5	Shërbime prokurimi për zyrat	Shërbim	Blerje me vlerë të vogël	191,666	08.03.2018	Pastrime Silvion K91413010N	159,100	Komiteti Shtetëror për Kultet
6	Materiale pastrimi	Mall	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	25,000	30.03.2018	LUMTURI XHENGO K61422018E	13,430	Komiteti Shtetëror për Kultet
7	Blerje Karburanti	Mall	Blerje me vlerë të vogël	583333.00	22.05.2018	A&T	261,486	Komiteti Shtetëror për Kultet
8	Pjese nderrimi, goma bateri per automjet VOLVO XC90	Mall/ sherbim	Blerje me vlerë të vogël	375000.00	18.05.2018	NOART	83,500	Komiteti Shtetëror për Kultet
					03.08.2018	Vol-AI Service	68,000	Komiteti Shtetëror për Kultet
9	Toner per printer dhe fotokopje	Mall	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	100000.00	18.06.2018	InfoSoft Office	96900	Komiteti Shtetëror për Kultet
10	Shërbime mirëmbajtje pajisje zyre	Shërbim	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	100000.00	31.10.2018	ANORIA	11,883	Komiteti Shtetëror për Kultet
11	Bileta transporti ajror ndërkombëtar	Shërbim	Blerje Dinamike e Biletave për Transportin Ajror Ndërkombëtar	600,000	12.11.2018	Golden Travel	43,750	Komiteti Shtetëror për Kultet
12	Pritje përcjellje	Shërbim	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	100000.00	13.11.2018	I.H.G	93,333	Komiteti Shtetëror për Kultet
13	Mbushje të fikëseve të zjarrit	Shërbim	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	5000.00	06.12.2018	VJOLLCA LOGU	5,000	Komiteti Shtetëror për Kultet
14	Siguracion automjeti	Shërbim	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	60,000	12.12.2018	EUROSIG	49,726	Komiteti Shtetëror për Kultet
15	Shërbime printimi	Shërbim	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	100,000	17.12.2018	DHIMITER VASI	30,792	Komiteti Shtetëror për Kultet
16	Shërbime mirëmbajtje hidraulike, elektrike	Shërbim	Blerje nën vlerën 100,000 lekë	100,000	17.12.2018	FRADA	33,070	Komiteti Shtetëror për Kultet

Bulevardi Zogu I, Nd. 9, H. 4, Ap. 7, 1016, Tiranë; Tel –35504222/131; e-mail: komitetishk@kshk.gov.al

5 – REKOMANDIME

Viti 2018 ka shënuar një nivel të kënaqshëm realizimi objektivash për institucionin. Klima paqësore dhe konstruktive e bashkëpunimit midis bashkësive fetare dhe mes tyre e shtetit, në zgjidhjen e problemeve sociale, e dëshmon këtë. Megjithatë efikasiteti i KSHK duhet përmirësuar për vitin 2019 nëpërmjet rritjes së iniciativës në ndërmarrjen e veprimeve që përmblihen në mision ligjor të tij, në thellimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera qendrore dhe vendore dhe në zgjerimin e promovimit ndërkombëtar të harmonisë fetare në vend.